



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:139749

Datë: 22.05.2024

Numri i dokumentit: 05717352

A.C.nr.3032/21

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Bujar Muzaqi kryetar i kolegjit, Enes Mehmeti dhe Hysni Bardheci, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike të paditëses A.I., me vendbanim në rr. “...”, nr..., Komuna Istogut të cilën e përfaqëson me autorizim F.K., avokat me seli në Komuna Pejë, kundër të paditurës Kompania e sigurimeve “K...”, me seli në rr. “...”, p.n, Komuna Prishtinë, të cilën e përfaqëson V.R., zyrtarë ligjorë pranë të paditurës, në çështjen kontestimore për kompensimin e dëmit nga baza e sigurimit të auto përgjegjësisë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditëses, dhe të paditurës të parashtruar kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Pejë, Dega në Istog, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.251/19 datë 09.03.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 20.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pathemeltë, ankesa e të paditurës Kompania e sigurimeve “K...”, me seli rr. “...”, p.n, Komuna Prishtinë dhe ankesa e paditëses A.I., me vendbanim në rr. “...”, nr..., Komuna Istogut, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë, Dega në Istog, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.251/19 datë 09.03.2021, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin C.nr.251/19 datë 09.03.2021, ndër të tjera ka vendosur si vijon:

“... APROVOHET PJESËRISHT SI E BAZUAR kërkesë padia e paditëses A.I., nga Istogu.

I. DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve "K..", rr. " .." pa. në Prishtinë, që në emër të kompensimit të dëmit, për aksidentin e datës: 19.09.2017, ti paguaj shumat e specifikuara si më poshtë:

Dëmi jo material:

- për dhimbjet e përjetuara fizike 2,500 Euro.
- për shkak të frikës së përjetuar 1,500 Euro.
- për zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm për jetë..... 9,600. Euro.
- për shëmtim trupor 1,000 Euro.

Dëmi material

- Në emër të shpenzimeve te mjekimit, trajtimit mjekësor, transportit ne Gjermani ..14.900 Euro.

II. REFUZOHET PJESËRISHT SI E PABAZUAR, kërkesë padia e paditëses A.I. nga Istogu, përtej shumës së gjykuar, në pikën I, në dispozitivin e këtij aktgjykimi, për aksidentin e datës 19.09.2017, për shumat e specifikuara si më poshtë:

Dëmi jo material:

- për dhimbjet e përjetuara fizike 2,500.00 Euro.
- për shkak të frikës së përjetuar 3,500.00 Euro.
- për zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm për jetë..... 30,400.00 Euro.
- për shëmtim trupor 4.000 Euro.

Dëmi material

- ne emër të ndihmës dhe kujdesit te huaj..... 1,200 euro.
- për ushqim të perforcuar..... 500 Euro
- Në emër të shpenzimeve te mjekimit..... 500 Euro.

III. DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve “K...”, rr. “...” pa. Prishtinë, që shumat e gjykuara, si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, ti paguaj me kamat ligjore prej 8%, duke filluar nga data 09.03.2021 e deri në pagesën definitive, e të gjitha këto në afat prej 15 dite, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me detyrueshëm.

IV. DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve “K...”, rr. “...” pa. Prishtinë, që paditësit ti paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në lartësi prej 936 Euro, e të gjitha këto, ti përbush në afat prej 15 dite, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me detyrueshëm...”.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë e paditura, për shkak të : shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim Gjykatës së Apelit në Prishtinë, që ta aprovoj ankesën e të paditurës Kompania e sigurimeve “K...”, me seli në Prishtinë, si të bazuar, të prishet aktgjykimi i Gjykatës së shkallës së parë dhe lënda të i kthehet në rivendosje dhe rigjykim gjykatës së shkallës së parë, ose të ndryshohet aktgjykimi i ankimuar dhe të gjykohet në shumën e ofruar nga e paditura.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë paditësja, me propozim Gjykatës së Apelit që aktgjykimin e Gjykatës së shkallës së parë ta ndryshoj nën pikën II të dispozitivit dhe ta aprovoj kërkesëpadinë mbi shumën e gjykuar si në pikën I të dispozitivit për të gjitha kërkesat që kanë të bëjnë me kompensimin e dëmit material dhe jo material ose aktgjykimin në fjalë në pjesën refuzuese të Prishet, dhe çështjen ta kthej në rigjykim.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 194 të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore dhe gjeti se:

- Ankesat e palëve ndërgjyqëse, janë të pathemelta.

Nga shkresat e lëndës konstatohet se paditësja A.I., me vendbanim në rr. “...”, nr..., Komuna Istogut, me datë 28.06.2019, ka paraqitur padi ndaj të paditurës, Kompania e sigurimeve “K...”, me seli rr. “...”, p.n, Komuna Prishtinë, me kërkesë për kompensimin e dëmit material dhe jo material nga baza e sigurimit të autopërgjegjesisë.

Gjykata e shkallës së parë pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor me datë 09.03.2021, pas dëgjimit të palëve ndërgjyqëse dhe pas administrimit të provave, ka nxjerrë aktgjykim C.nr.251/19 datë 09.03.2021, me të cilin aktgjykim e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses A.I., duke vendosur me decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktgjykimit të atakuar ndër të tjera ka arsyetuar se: *“...në rastin konkretë në mes palëve ndërgjyqësve nuk ka qenë kontestuese baza juridike e kërkesë padisë sa i përket shkaktarit të aksidentit as sa i*

përket natyrës së lëndimeve por vetëm lartësia e kërkesë padisë, prandaj gjykata nuk u lëshua në arsyetimin e vendimit sa i përket provave që i referohen bazës juridike të kërkesë padisë duke u mbështetur në dispozitën e nenit 321 të LPK-së... E paditura i ka kontestuar shpenzimet e udhëtimit lidhur me transportimin e paditëses në Shtetin Gjerman për trajtim të mëtuajtshëm shëndetsor. Kjo nuk qëndron pasi që dihet që ne rastet e shkaktimit të demit duhet të rivendoset gjendja e mëparshme dhe të kompensohet e dëmtuara plotësisht, nga provat e administruara vërtetohet se paditëses si rezultat i aksidentit ka qenë e detyruar të shkoji për tretman shëndetësor, e që ka lind si rezultat i lëndimeve të pësuar në aksident dhe ekziston lidhje kauzale shkak – pasojë, dhe ky kundërshtim është në tërësi të pabazuara dhe përpjekje për të ikur përgjegjësisë. Po ashtu dihet se pretendimet ashtu edhe kundërshtimet duhet të provohen në një proces kontestimor nga palët. Paditësja ka arritur që kërkesën e vet ta argumentojnë me provat e propozuara dhe të administruara nga gjykata, ndërsa kundërshtimet e të paditurës janë tërësisht të pa bazuara, sepse ka qenë detyrim i të paditurës, e që një detyrim i tillë rrjedh nga dispozitat e ligjit të marrëdhënieve të detyrimeve, neni 136, ku thuhet “kush shkakton tjetrit dem ka për detyrim të ia kompensojë atë, përveç nëse provon se demit ka lindur pa fajin e tij...”.

Gjykata e Apelit e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe nuk ka shkelje nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m), të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore, nuk ka aplikim të gabuar të drejtës materiale për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Gjykata e Apelit duke marrë parasysh të gjitha provat e administruara në këtë çështje juridike dhe atë se me datë 19.09.2017, rreth orës 14:20, në rrugën Gurrakoc-Pejë, ka ndodhur aksident trafiku në mes veturës të markës “xxx”, me targa të regjistrimit “xxx”, e siguruar pranë kompanisë së sigurimeve, “K...”, në Prishtinë, dhe paditëses A.I., ku e siguruar e të paditurës e cila e ka humbur kontrollin e automjetit, dhe kalon në krahun e kundërt të korsisë, dhe godet automjetin tjetër të markës, xxx, me targa të regjistrimit xxx, duke e goditur në pjesën ballore kombin, dhe me atë rast nga goditja ka pësuar lëndime të rënda trupore, në pasoja të përhershme, tani A.I., bashkëshortja e A.I., e cila ka qenë bashkudhëtare në veturën e bashkëshortit të vet, dhe me atë rast e njëjta për shkak se ka pasur lëndime të rënda trupore, fillimisht është dërguar për ndihmë mjekësore në Spitalin e Përgjithshëm të Pejës, dhe pastaj është dërguar me helikopter për shërim të mëtejshëm në Koln, Gjermani, dhe nga kjo rrjedh dhe e drejta e paditëses dhe detyrimi i të paditurës për kompensimin e demit material dhe jo material.

Po ashtu edhe e paditura në ankesën e dorëzuar në Gjykatë me datë 31.03.2021 ndër të tjera ka deklaruar se “E paditura,... ka bërë ofertë prej 8.320,00 euro për të gjitha format e demit material dhe jomaterial...”.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, ka vendosur drejtë, pasi që paditëses i takon e drejta në kompensim të dëmit material dhe jo material duke u bazuar në dispozitat e nenit 136,169,174 të Ligji nr.04/l-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, andaj shumat e gjykuara si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar për paditësen A.I. dhe atë në emër të dëmit material dhe jo material, dhe atë për dhimbje të përjetuara fizike shumë prej 2,500 euro, për shkak të frikës së përjetuar shumë prej 1,500 euro, për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor 9,600 euro, për shëmtim trupor shumë prej 1,000 euro si dhe në emër të shpenzimeve të mjekimit shumë prej 14,900 euro, janë reale duke u bazuar edhe në mendimin e ekspertëve mjekësor Dr.V.B, Ortopedë dhe Dr.M.H, Neuropsikiatër, të cilët kanë dhënë mendimin e tyre profesional pas ekzaminimit të drejtpërdrejtë të paditëses, dhe të cilët janë deklaruar për natyrën, shkallën dhe pasojat e lëndimeve që ka pësuar paditësja si pasojë e këtij aksidenti. Sipas ekspertes, Dr.V.B, ortopedë - traumatologe, bazuar në raportet mjekësore që gjinden në shkresat e lëndës dhe raportet e lëshuara nga Spitali i Pejës, dhe atë me nr. 16486, te dt. 19.09.2017, flete lëshimi ne epikrizë te lëshuar nga reparti ortopedisë së Pejës, me nr. 7810, ku ka qëndruar prej dt.19.09.2017 deri me 24.09.2017 dhe pastaj u transferua në Vjenë, dhe i është nënshtruar intervenimit kirurgjikal ne dorën e djathte, dhe acetabellumi apo qetinë e majte, paditësja ka pësuar këto lëndime trupore : thyerje të pjesës së radiomit të poshtëm dhe udhnes (parakrahut) distral të majtë, frakturë e acitabillumit të majtë, me lluksasion të artikulacionit sakro iliakal të majtë. Këto lëndime bëjnë pjese në lëndime të rënda trupore me pasoja të përhershme, paditësja ka përjetuar dhimbje fizike të intensitetit posaçërisht të rënd, në kohëzgjatje prej rreth një orë, duke marrë parasysh vendndodhjen e aksidentit dhe deri në transferimin në qendrën emergjente të Spitalit të Pejës, realizimi i analizave dhe ekzaminimeve radiologjike dhe marrjes së ndihmës së parë dhe analgjetikëve. Dhimbje fizike të intensitetit të rëndë në kohëzgjatje prej 4 ditësh, në marrje të terapisë kundër dhimbjeve, pasi që e njëjta i është nënshtruar edhe dy intervenimeve kirurgjikale, njërën në dorën e djathtë dhe tjetrën në regjionin e polikut. Dhimbje fizike te intensitetit te mesëm që kanë zgjatur për 30 ditë duke përfshirë kohën ramjës së ajtjes hematomës, dhe formule të kalusit primar, pas frakturës tatuarave dhe atë dhimbje kryesisht në regjion të byzylykut të dorës së djathtë dhe regjionit të konvikut. Dhimbje fizike të intensitetit të ulur, që posedon akoma në ecje me të gjata ngritje nga pozita e ulur ecje në shkallë, sforcime fizike, dhe ndërrime klimatike. Paditësja ka zvogëlim të aktiviteteve jetësore në shkallën prej 24 %, dhe atë për shkak të artrozës, dhe kontrakturës së nyjës së kërdhokullës së majtë, pas intervenimit të shkallës së mesme pika 2.2.3 nen b), që përfshinë 15 %, e që e ka konstatuar edhe në radiografi që gjendën në shkresat e lëndës, si dhe pas ekzaminimit klinik, pastaj për shkak të kontrakturës së nyjës se byzylykut të dorës së djathtë të shkallës së lehtë pika 1.4.2 nen a 6%, e që është e shprehur në fleksionin dorëzal të byzylykut, si dhe për shkak të dhimbjes pas luksacionit dhe diastazës pubike, pika 4.1.1 5%, e të cilat të përlllogaritura me formulën e baltazarit, japin zvogëlimin prej 24 % e që është i përhershëm. Paditësja ka shëmtim trupor te shkallës së mesme, dhe atë për shkak të: dy vrazave të mbetur në byzylykun e dorës së djathtë, njëra me gjatësi prej 12 cm, dhe tjera 10 cm, si dhe për shkak të vrazjes së mbetur në regjionin e kofshës së majtë me gjatësi prej 30 cm, si dhe

për shkak të vështirësive në ecje që shprehet me një qalim të lehtë, e të cilat japin ketë shëmtim, i është nevojitur ushqim i përforcuar në kohëzgjatje prej 10 javësh, i pasur me proteinë minerale dhe vitamina, për përmirësim të gjendjes së përgjithshme pas lëndimeve të pësuar. I është nevojitur ndihma e personit tjetër në kohëzgjatje prej 10 jave, sa nuk e ka pasur të lejuar ecjen e deri në periudhën e fillimit të ecjes me ndihmën e kupëzave, pra ndihmë në veshë mbathje, mbajtje të higjienës personale dhe kryerjen e aktiviteteve jetësore. I është nevojitur terapi fizikale në kohëzgjatje prej 2 javësh, në vitin e parë pas aksidentit si dhe nga dy javë në vitin e dytë dhe në vitin e tretë pas aksidentit. Po ashtu, sipas ekspertit, Dr.M.H, neuropsikiatër, në bazë të dokumentacionit mjekësorë si dhe ekzaminimit direkt të aksidentuarës A.I., është konstatuar se e njëjta se ka përjetuar frikë primare të intensitetit të lartë në kohëzgjatje prej disa sekondave, kjo periudhë është përcjell me shtangim afektiv, dhe frikë nga vdekja drejtpërdrejtë, frikë sekondarë me intensitet të lartë, ka pasur në periudhën kohore gjer në 3 orë, të manifestuar me mundim, të rrahura të shpejtuara të zemrës frymëmarrje të vështirësuar dridhje të muskujve, djersitje dhe ankesa të tjera trupore, frikë sekondare, me intensitet të mesëm ka pasur me periudhën kohore deri 3 muaj, e që është manifestuar me një çrregullim të stabilitetit, psikofizike, si pasojë aksidentit si indisponim pengesa të herë pas herëshme në gjumë rikujtim të ngjarjes traumatikë, kufizim të pjesërishëm, në aktivitete jetësore shkallë më të ulët të tolerancës frustative, dhe ankesa të tjera trupore, frikë sekondarë me intensitet të ulët ka pasur në periudhën kohore gjer në 6 muaj, e që është manifestuar gjatë kohës kur ka dalë në komunikacion apo ngjarje që ia rikujton aksidentin, gjendje faktike kjo e vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë.

Në nenin 136 par.1 të Ligjit për Mardhëniet e Detyrimeve në mënyrë decidive thuhet se *“Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”.*

Ndërsa në nenin 183 par.1 të Ligjit për Mardhëniet e Detyrimeve ndër të tjera thuhet se *“Për dhembjet e pësuar fizike, për dhembjet e pësuar shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm, si dhe frikës, gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyejnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla...”.*

Pretendimi ankimor i të paditurës se nuk ka faturë të transportit me helikopterë në vlerë prej 14.900,00 Euro, ky pretendim është i pa bazuar pasi që në shkresat e lëndës është fatura 2017 -2856 datë 25.09.2017 në të cilën faturë ndër të tjera thuhet se *“...Pacienti: A., ...vendi dërgues : Spitali regional Pejë, destinacioni : Cologne Bonn Airport ...Gjermani...E-çmim 14.900,00 €...”.*

Ndërsa në nenin 179 par.1 të Ligjit për Mardhëniet e Detyrimeve ndër të tjera thuhet se *“Kush i shkakton tjetrit lëndim trupor ose ia dëmton shëndetin ka për detyrë të shpërblejë shpenzimet rreth mjekimit dhe shpenzimet tjera të nevojshme lidhur me këtë...”.*

Pretendimi ankimor se gjykata e shkallës së parë është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, nuk qëndron pasi që dispozitivi i Aktgjykimit është i kuptueshëm, i kuartë dhe arsyetimi i Aktgjykimit përmban të gjitha faktet vendimtare, dhe arsyet pse është vendosë si në dispozitiv të Aktgjykimit.

Gjykata e Apelit i vlerëson si të pa bazuara pretendimet në ankesë të palës së paditur se Gjykata e shkallës së parë gabimisht ka zbatuar të drejtën materiale, sa i përket lartësisë së kompensimit, pasi vlerëson se shumat e gjykuara nga Gjykata në shkallë të parë, janë reale duke u bazuar edhe në lëndimet e pësura nga paditësja.

Pretendimi ankimor i të paditurës lidhur me shpenzimet procedurale, është i pa bazuar, pasi që vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë se shpengimeve dhe në pajtim me dispozitat e nenit 452 par. 1 të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore.

Janë vlerësuar edhe pretendimet tjera ankimore të paditëses dhe të paditurës, por Gjykata e Apelit nuk ka gjetur se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në ndonjë shkelje, prandaj të gjitha pretendimet janë vlerësuar si të pabazuara.

Nga të cekurat u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në bazë të nenit 195.1 pika d), e lidhur me nenin 200 të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
A.C.nr.3032/21 datë 20.05.2024

Kryetari i kolegjit - gjyqtari,
Bujar Muzaqi